

Data 24.08.2026

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**Objekti i procedurës: “Shërbimi Mirëmbajtje e Sistemit të Kondicionimit AC
Industriale”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45331000-6.
(Punime ngrohje, ventilimi dhe kondicioneresh).

Vlera e fondit limi: 3 533 940.67 (tre milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Identitek sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në 70 678.81 (shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e një).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarres duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihet të paktën **kategoria** e mëposhtme:

- **NS12** - Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu vlerësohet se, ne reference te VKM-se nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të kërkohet **Licensa profesionale përkatëse me kategorinë N.S-12** (impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit), duke paraqitur kopje te vlefshme te saj.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose të përditësuar dhe/ose ekuivalent), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO/IEC 14001:2015** (ose të përditësuar dhe/ose ekuivalent), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: ISO 14001 parashikon një tërësi kërkesash dhe rregullash për zbatimin e një sistemi efektiv të menaxhimit mjedisor, duke përfshirë identifikimin dhe kontrollin e ndikimeve mjedisore, menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e përgjegjshëm të burimeve, parandalimin e ndotjes dhe respektimin e kërkesave ligjore mjedisore. Kjo kërkesë është e lidhur me objektin e prokurimit, pasi mirëmbajtja e sistemeve industriale të kondicionimit mund të përfshijë ndërhyrje në pajisje, gazra ftohës, vajra dhe komponentë teknikë, të cilët kërkojnë trajtim të kontrolluar. Disponimi i kësaj certifikate dëshmon se operatori ekonomik zbaton standarde ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor gjatë ushtrimit të aktivitetit dhe realizimit të shërbimeve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023,2024,2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% të fondit limit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë minimumi 3 punonjës me kualifikimet si më poshtë:

- 1 (një) Drejtues teknik –Inxhinier teknik /Hidroteknik/Elektrik.
- 2 (dy) Punonjës/Specialist për sistem ngrohje-ftohjeve/kondicioner.

a) Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Teknik/Hidroteknik/ Elektrik.
- Kontrate pune perkatese.

b) Për punonjësın Specialist per sistem ngrohje ftohje/kondicioner, te paraqitet:

- Çertifikatë kualifikimi, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pikat 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar natyres se shërbimeve që prokurohen sqarojmë se stafi teknik i kualifikuar profesionalisht është kërkuar ne raport me shërbimet qe kërkohen te realizohen te cilat jane elektrike, mekanike etj.

Argumentim mbi specifikimet teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në funksion të objektit të procedurës së prokurimit “**Shërbimi mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit AC industriale**”, duke marrë në konsideratë tipologjinë, kapacitetin, karakteristikat teknike dhe kompleksitetin e pajisjeve ekzistuese që do t'i nënshtrohen mirëmbajtjes. Sistemi përbëhet nga pajisje industriale kondicionimi me kapacitete të ndryshme, për të cilat kërkohet garantimi i funksionimit të vazhdueshëm, të sigurt dhe me eficiencë.

Specifikimet përfshijnë elementët kryesorë të sistemit, si **filtrat e ajrit, kompresorët, presostatet, valvulat, sensorët e temperaturës dhe lagështisë, ventilatorët, komponentët e lagështuesit, elementët elektrikë dhe elektronikë, kontrolluesit, panelet e komandimit, tubacionet dhe elementët e qarkut frigoriferik**, të cilët janë të domosdoshëm për funksionimin normal të sistemit AC industrial.

Përcaktimi i standardeve teknike **EN, IEC, ISO ose ekuivalent** për komponentët përkatës është bërë me qëllim që pjesët dhe materialet që do të përdoren gjatë mirëmbajtjes të plotësojnë kërkesat e nevojshme të cilësisë, sigurisë dhe performancës teknike dhe të jenë të përshtatshme për funksionimin e sistemit ekzistues. Referimi ndaj standardeve teknike synon të përcaktojë nivelin minimal të kërkuar të performancës dhe cilësisë dhe jo kufizimin e konkurrencës në një prodhues të caktuar.

Një pjesë e rëndësishme e specifikimeve lidhet me **kontrollin dhe mirëmbajtjen periodike parandaluese**, e cila është e nevojshme për evidentimin në kohë të konsumimit, dëmtimeve apo anomalive dhe për parandalimin e defekteve që mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionimit të sistemit. Për këtë qëllim është parashikuar kontrolli i ventilatorëve, zhurmave, vibrimeve,

lidhjeve elektrike, konsumit të energjisë, si dhe pastrimi periodik i pajisjeve. Specifikimet për **panelin elektrik** janë të nevojshme për garantimin e furnizimit dhe funksionimit të sigurt të pajisjeve. Kontrollat përfshijnë verifikimin dhe shtrëngimin e lidhjeve elektrike, kontrollin e kontaktorëve, matjen e tensionit të furnizimit dhe verifikimin e parametrave nominalë të pajisjeve, me qëllim parandalimin e mbinxehjeve, dëmtimeve dhe defekteve elektrike.

Kontrolli dhe mirëmbajtja e **sistemit elektronik të kontrollit dhe monitorimit** është parashikuar për të garantuar funksionimin korrekt të komandimit, sinjalizimeve dhe alarmeve të sistemit. Në këtë kuadër kërkohet kontrolli i eventeve të regjistruara, pajisjeve të sigurisë, sensorëve, sinjaleve hyrëse, logjikës së kontrollit, konfigurimit të kontrollorit dhe kalibrimit të sensorëve sipas specifikimeve teknike të prodhuesit. Gjithashtu, mirëmbajtja e **qarkut të fuqisë së panelit elektrik** është e domosdoshme për funksionimin e sigurt të sistemit, ndaj është parashikuar kontrolli i tensioneve gjatë punës nën ngarkesë, matja e konsumit të energjisë, kontrolli dhe kalibrimi i elementëve funksionalë dhe verifikimi i pajisjeve mbrojtëse dhe të sigurisë. Për **njësinë e jashtme/kondensatorin**, specifikimet parashikojnë kontrollin e gjendjes së kondensatorit dhe ventilatorit, verifikimin e fiksimeve mekanike dhe lidhjeve elektrike, pastrimin e serpentinave dhe kontrollin e elementëve elektronikë të komandimit. Këto ndërhyrje janë të nevojshme për ruajtjen e eficiencës së shkëmbimit termik dhe funksionimin normal të sistemit. Rëndësi të veçantë paraqet **qarku i mbyllur frigoriferik**, për të cilin kërkohet kontrolli i parametrave të funksionimit, temperaturave, presioneve, kompresorit, valvulave dhe pajisjeve të sigurisë, si dhe kontrolli i tubacioneve për rrjedhje, dëmtime ose korrozion. Gjithashtu, parashikohet verifikimi i parametrave *Superheat* dhe *Subcooling*, si dhe monitorimi i presioneve të punës, me qëllim evidentimin e anomalive dhe garantimin e funksionimit të sistemit brenda parametrave të përcaktuar nga prodhuesi. Kryerja e **testeve të funksionalitetit** është parashikuar për të verifikuar pas ndërhyrjeve funksionimin e ventilatorëve, lagështuesve, ngrohësve elektrikë, elementëve të rregullimit të rrjedhës së ajrit dhe qarqeve hidraulike, si dhe sekuencën e funksionimit të sistemit sipas logjikës së kontrollit dhe parametrave të programuar.

Kërkesat për **pjesët e këmbimit** janë përcaktuar me qëllim garantimin e cilësisë dhe gjurmueshmërisë së materialeve që do të instalohen. Për këtë arsye kërkohet që ato të jenë të reja, cilësore dhe sipas specifikimeve, të kenë ambalazh origjinal dhe të shoqërohen me të dhënat identifikuese përkatëse. Garancia jo më pak se 12 muaj synon të sigurojë që pjesët e furnizuara dhe të vendosura të ruajnë funksionalitetin dhe cilësinë e kërkuar gjatë përdorimit.

Gjithashtu, kërkesa për **garancinë e shërbimit** synon të garantojë përgjegjësinë e operatorit ekonomik për cilësinë e ndërhyrjeve të kryera. Dorëzimi i dokumentacionit teknik dhe certifikatës së konformitetit në përfundim të punimeve shërben për të dokumentuar se ndërhyrjet janë realizuar në përputhje me kërkesat teknike, specifikimet e prodhuesit dhe standardet përkatëse.

Përcaktimi i **gatishmërisë 24 orë/365 ditë dhe paraqitjes së grupit të punës brenda 2 orëve për problematikat kritike** është i lidhur me rëndësinë e funksionimit të vazhdueshëm të sistemeve industriale AC dhe nevojën për ndërhyrje të shpejtë në rast defekti. Për problematikat

që nuk sjellin ndërprerje të shërbimit është parashikuar një afat më i gjerë, deri në 3 ditë pune, duke diferencuar në mënyrë proporcionale kohën e reagimit sipas rëndësisë së problematikës.

Në përfundim, **specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor dhe karakteristikat e sistemit ekzistues**, me qëllim garantimin e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, ruajtjen e performancës dhe eficiencës së pajisjeve, parandalimin e avarive dhe sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit AC industrial. Kërkesat teknike synojnë përcaktimin e nivelit të nevojshëm të cilësisë dhe sigurisë për realizimin me sukses të kontratës dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e saj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.09.2026 Ora: 12:00.